

JEMI QYTETARË ME NDËRGJEGJE TË PASTËR



TË GJITHË TË BARABARTË

MUHAMED (11), ERIS D. (10), TUANA R. (10), ERON (10), BLEND (10), ERIS K. (10), SUELA (10)



Demokracinë duam që ta kemi gjithmonë. Prandaj, duhet ta ruajmë dhe të punojmë në ndërtimin e saj

Një ditë të bukur pranvere, unë dhe shoqet e mia dolëm për të luajtur në lagje. Pak më tutje, vërejtëm edhe disa fëmijë të tjerë, të cilët gjithashtu po luanin



së bashku. U afruam për të luajtur edhe ne me ta. Në të njëjtën kohë, edhe një vajzë tjetër e lagjes sonë, e cila është 3 vjet me e vogël se ne, u afrova për të na u bashkangjitur ne dhe fëmijëve të tjerë të lagjes. Papritmas, u dëgjua një zë që tha: „Tina, ti je e vogël, nuk mund të luash me ne. Largohu!“. Unë u ndjeva shumë keq dhe u afrova tek personi i cili tha kështu. Me shumë qetësi i thashë: „Leonis, nuk mund të përjashtosh dikë nga grupi, vetëm pse është më i/e vogël në moshë se ti.“ Nuk ndalova me kaq. Vazhdova të flas për demokracinë. ”A ke dëgjuar për demokracinë?


Vendi ynë është demokratik dhe të gjithë jemi të barabartë dhe kemi të drejta të barabarta. Prandaj, edhe Tina do të luajë me ne, sepse edhe ajo ka të drejtën e lojës.“ Leonisi, u pajtua plotësisht me mua. Pastaj, ai i tha Tinës se edhe ajo mund të luajë me ne. Gjithashtu, i kërkoi falje se nuk ishte sjellur shumë mirë me të. Në këtë mënyrë, të gjithë fëmijët e lagjes sonë luajnë së bashku dhe nuk e ofendojnë njëri-tjetrin. Kjo është demokracia jonë. Të gjithëve na konsideron të barabartë. E përmendëm se të gjithë kemi të drejtë të barabartë të luajmë. Përpos barazisë, elementet e tjera të demokracisë janë: toleranca, solidariteti, liria, paqja, respekti, etj. Ne duhet të jetojmë në bazë të këtyre elementeve. Ne iu falenderojmë nga zemra që e lexuat këtë artikull. Në artikujt e tjerë do të mund të informoheni për temat e tjera, si: Kuvendi dhe zgjedhjet.



Autorët e artikullit të cilët janë shumë të përgjegjshëm

KUVENDI MENDON EDHE PËR NDOTJEN E AJRIT

MELISA (10), GERTA (11), RIAD (10), ADHURIM (10), VALTON (10), ERONA (10), TUANA (10)



Rëndësia e institucionit më demokratik të vendit, shihet në çdo hap të jetës sonë. Ky institucion është Kuvendi i Kosovës, i cili brenda vetes përfshin një mori përgjegjësish dhe detyrash

Populli me mendjen dhe dorën e tij, mund të bëjë mrekulli. Kjo mrekulli që mund ta bëjë populli, vjen nga fuqia që ka secili qytetar i Kosovës. Qytetarët kanë fuqi, sepse ata kanë pushtetin në duart e tyre. Një votë e tyre mund të ndikojë që të ndryshohet e tërë qeverisja e vendit. Një vendim i drejtë dhe i menduar mirë

2004. Ky ligj ka për qëllim që të rregullojë dhe garantojë të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit nga ndotja e ajrit.“ E shihni pra, qytetarë të dashur se Kuvendi mendon shumë gjëra të mira për ne? Po ta mendosh se sa rëndësi ka ambienti ku jetojmë, do ta kuptojmë thellë se pa ligje të tilla, qytetarët do të kishin edhe probleme të ndryshme shëndetësore. Andaj, shumica e iniciativave të qytetarëve bazohet në ruajtjen e ambientit dhe sigurimin e një mjedisi të pastër. Këtu vihet në pah sesa e rëndësishme është ruajtja e ambientit nga ana e qytetarëve. Prandaj, duhet të jemi shumë falënderues që jetojmë në demokraci dhe që kemi Kuvend që mendon dhe punon për ne. Ne jemi ata të cilët mund t'iu japim edhe më shumë vlerë ligjeve, duke raportuar dhe tërhequr vërejtjen e qytetarëve të cilët ndotin ajrin. Të shëndetshëm edhe të lumtur mund të ecim përpara.




Ligji për mbrojtjen e ambientit ka rëndësi të madhe për ne

paraprakisht i popullit, vendos se si do të qeveriset vendi për 4 vjet. Populli i mirë zgjedh deputetët e mirë. E pikërisht, deputetët janë ata të cilët propozojnë dhe miratojnë ligjet që i japin kuptim dhe vlerë jetës sonë. Çdo ditë ne jemi përfitues të ligjeve. E themi këtë duke u nisur që nga ajri që thithim në baza ditore, mbrojtja e të cilit parashihet edhe me ligj, të miratuar në vitin



Ne e ruajmë ambientin ku jetojmë



Shkollimi, kjo e drejtë kaq e dashur për ne. Ne në shkollë shkojmë me shumë gëzim



Të gjithë në mënyrë të barabartë e pa asnjë dallim, e kemi të drejtën e mjekimit

DEMOKRACIA




Të gjithë fëmijët e botës meritojmë të jemi të lumtur. Andaj, respektoni të drejtat tona



Ky vizatim flet për diversitetin në demokraci. Pavarësisht dallimeve, ne të bashkuar mund të arrijmë sukses

QYTETARËT JANË VENDIMMARRËS

DARDAN (10), ERJON G. (10), ERDITA (10), ERION B. (10), VERONA (10), ERION Z. (10), ERINA (10)



Kur erdhëm në „Demos-ti“ nuk e dinim se për çfarë teme do të flisnim. Pasi u ndamë në grupe ne filluam të flisnim për zgjedhjet. Në këtë artikull ne kemi paraqitur informatat që i morëm lidhur me këtë temë

Artikullin dëshirojmë ta fillojmë duke iu treguar diçka për demokracinë. Ne mësuam se fjala demokraci do të thotë qeverisje nga populli. Ajo rrjedh nga Greqia dhe ka lindur në Athinë. Për neve është shumë e rëndësishme demokracia. Kjo për shkak se ajo na jep të drejtë të zgjedhim vetë përfaqësuesit tanë. Këta përfaqësues punojnë për neve, por vetëm për një kohë të caktuar. Kjo dallon nga monarkia, pasi që një mbret apo mbretëreshë e mban titullin e tij/saj deri në vdekje. Procesi me anë të të cilit ne zgjedhim përfaqësuesit quhet proces zgjedhor. Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve: parlamentare ose qendrore dhe zgjedhjet komunale ose lokale. Në zgjedhje parlamentare ne votojmë deputetët të cilët janë 120 në numër. Ata punojnë në Kuvendin e Kosovës. Deputetët kanë detyrë të kujdesen për çdo qytetar. Ne kërkojmë nga ata që të ndërtojnë shkolla, të sjellin libra për nxënësit, të ndërtojnë dhe të rregullojnë parqe, të sigurojnë ligje të mira për neve dhe të marrin vendimet e duhura, duke i pasur qytetarët në mendjet e tyre. Kurse, gjatë zgjedhjeve lokale, ne përzgjedhim kryetarin dhe asamblistët e një komune të caktuar. Vetëm qytetarët e një komune kanë të drejtë të votojnë për kryetarin dhe asam-

blistët e asaj komune. Ne si fëmijë, pasi që jemi nën moshën 18 vjeçare nuk mund të votojmë, sepse nuk jemi ende të pjekur mjaftueshëm. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se nuk zgjedhim në jetën tonë të përditshme. Në vijim mund të lexoni disa shembuj kur edhe ne zgjedhim. Në mëngjes, pasi pastroj fytyrën, unë ashtu si shokët e tjerë të grupit, zgjedh rrobat që do t'i vesh për në shkollë. Këtë e bëj për çdo ditë. Pasi përfundoj orët mësimore, unë shkoj në bibliotekë. Aty përzgjedh një libër për të lexuar, libër të cilin e marrë në shtëpi. Kur dalim me prindërit për të blerë lodra, ato i zgjedhi unë. Kur luaj me shokët dhe kur nuk dijmë se cilën lojë ta luajmë ne përdorim votën për të përzgjedhur lojën e parapëlqyer. Edhe në të ardhmen, ne do të zgjedhim profesionin që do ta ushtrojmë. Vota asnjëherë nuk na ka lënë në baltë. Kur ne votojmë, ne gjejmë zgjidhje për problemet apo dilemën që kemi përpara.



Të gjithë gazetarët së bashku



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Zenet Hajdini“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë